



## **Federata e Para Boccia të Kosovës**

Në bazë të statutit të Federatës së Para Boccia të Kosovës, Bordi i Federatës së Para Boccia të Kosovës, me datë 22.05.2025 miraton këtë:

### **RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E GARAVE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE NË BOCCIA NË KOSOVË**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo rregullore synon të përcaktojë rregullat, parimet dhe procedurat për organizimin e garave të boccia në Kosovë, duke siguruar një standard të lartë sportiv, të drejtësi dhe transparencë, në përputhje me rregullat e BISFED.

#### **Neni 2 Fusha e Zbatimit**

1. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha garat vendore dhe ndërkombëtare të boccia që zhvillohen në territorin e Kosovës.
2. Aplikon për Federatën e Boccia të Kosovës, klubet anëtare, organizatorët e licencuar dhe të gjithë aktorët e përfshirë në organizimin e garave.

#### **Neni 3 Kategoritë e Garave**

1. Gara vendore në kategoritë BC1, BC2, BC3, BC4 dhe BC5:

- Garat Ekipore të Kampionatit të Kosovës në Boccia
- Garat Individuale të Kampionatit të Kosovës në Boccia
- Garat në Çifte të Kampionatit të Kosovës në Boccia
- Turner vendore në Boccia

## 2. Gara ndërkombëtare:

- Turne rajonale të organizuara në Kosovë
- Kampionate evropiane dhe botërore në bashkëpunim me BISFED dhe organizatat ndërkombëtare përkatëse.

### Neni 4

#### **Organizimi dhe Licencimi**

1. Organizatori i çdo gare duhet të jetë i licencuar nga Federata e Boccia e Kosovës.
2. Për çdo garë duhet të formohet një Komision Organizativ që përfshin përfaqësues nga Federata, klubet, dhe specialistë teknikë.
3. Komisioni Organizativ është përgjegjës për planifikimin, logjistikën, sigurimin e pajisjeve, dhe zbatimin e rregullores.
4. Garat duhet të mbikëqyren nga një Komision Gjyqtarësh të certifikuar nga Federata dhe BISFED, i cili garanton respektimin e rregullave të lojës dhe etikës sportive

### Neni 5

#### **Standardet Teknike dhe Ambienti i Garës**

1. Ambienti i garës duhet të jetë i përshtatshëm për lojtarët me aftësi të kufizuara, duke respektuar standardet ndërkombëtare të aksesibilitetit.
2. Tabela, sipërfaqja e lojës, dhe pajisjet e boccia duhet të jenë të certifikuara dhe në përputhje me rregullat e BISFED.
3. Organizatorët duhet të sigurojnë kushte të përshtatshme për publikun, mediat dhe pjesëmarrësit.
4. Klubet dhe lojtarët duhet të paraqiten në vendit ku caktohet aktiviteti garaues në kohë, të pajisur me fanela dhe pajisje tjera të nevojshme.
5. Duhet të ketë masa sigurie dhe evakuimi në rast emergjencash.

### Neni 6

#### **Regjistrimi i Garuesve dhe Kategoritë e Lojtarëve**

1. Garuesit duhet të jenë të anëtarësuar në Federatën e Boccia të Kosovës dhe të kenë dokumentacionin e plotë mjekësor dhe sportiv.

2. Regjistrimi bëhet nëpërmjet formularëve zyrtarë dhe në afatin kohor të përcaktuar nga organizatori dhe bëhet individualisht apo përmes klubeve të boccia për garat individuale dhe vetëm përmes klubeve të boccias për garat ekipore dhe garat çifte.

3. Lojtarët klasifikohen sipas kategorive të aftësive në përputhje me standardet BISFED, për të siguruar barazi dhe konkurrencë të drejtë.

4. Çdo lojtar mund të marrë pjesë vetëm në kategorinë e tij të klasifikimit.

#### Neni 7

### **Rregullat dhe Parimet e Garës**

1. Garat zhvillohen në përputhje të plotë me rregullat zyrtare të BISFED.

2. Respektohet strikt parimi i fair-play, respekti për kundërshtarin dhe etiketa sportive.

3. Çdo shkelje e rregullave sportive trajtohet sipas rregullores disiplinore të Federatës.

4. Nuk lejohet asnjë formë diskriminimi gjatë garave

#### Neni 8

### **Komisionet e Garës**

1. Komisioni Organizativ: Menaxhon të gjitha aspektet logjistike dhe administrative

2. Shoqata e Referëve: Zbaton rregullat e lojës dhe vendos për mosmarrëveshjet teknike gjatë garës.

3. Komisioni Disiplinor: Merret me hetimin dhe vendimmarrjen në lidhje me shkeljet disiplinore dhe ankesat.

4. Anëtarët e këtyre komisioneve duhet të janë të paanshëm.

#### Neni 9

### **Trajtimi i Ankesave dhe Apelimeve**

1. Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar brenda afatit prej 24 orësh pas përfundimit të garës.

2. Komisioni Disiplinor shqyrton ankesat dhe vendos brenda 72 orëve.

3. Vendimet e komisionit janë përfundimtare, por në raste të jashtëzakonshme mund të bëhet apel në Federatën Ndërkombëtare BISFED.

Neni 10  
**Masa Disiplinore**

1. Shkeljet e rregullave sportive mund të çojnë në paralajmërime, pezullime, ose përjashtim nga gara.
2. Masa disiplinore përcaktohen në përputhje me rregulloren disiplinore të Federatës së Boccia të Kosovës.
3. Çdo vendim disiplinor duhet të jetë i arsyetuar dhe i dokumentuar.

Neni 11  
**Masat e Sigurisë dhe Protokollet Shëndetësore**

1. Organizatori duhet të sigurojë kushte të sigurta për të gjithë pjesëmarrësit, përfshirë aksesin e shpejtë në shërbime mjekësore.
2. Në rast situatash emergjente shëndetësore, duhet të zbatohen protokollet dhe rekomandimet e institucioneve kompetente.
3. Siguria e lojtarëve, stafit dhe publikut është prioritet kryesor.

Neni 12  
**Dokumentacioni dhe Raportimi Pas Garës**

1. Organizatori dorëzon raportin e garës pranë Federatës së Boccia të Kosovës brenda 5 ditëve nga përfundimi i garës.
2. Raporti duhet të përfshijë:
  - Listën e garuesve dhe rezultate
  - Shkeljet dhe masat disiplinore, nëse ka pasur
  - Komentet dhe sugjerimet për përmirësim të organizimit
3. Federata mban arkivin elektronik dhe fizik të raporteve për monitorim dhe statistikë.

Neni 13  
**Garat Ndërkombëtare dhe Bashkëpunimi me BISFED**

1. Organizimi i garave ndërkombëtare në Kosovë duhet të bëhet në bashkëpunim dhe me miratimin e BISFED.
2. Respektohen të gjitha udhëzimet dhe standardet ndërkombëtare për lojtarët, arbitrat dhe organizatorët.
3. Federata e Boccia e Kosovës mbështet dhe promovon pjesëmarrjen e lojtarëve kosovarë në garat ndërkombëtare.

Neni 14  
**Dispozita Përfundimtare**

1. Çdo ndryshim në rregullore bëhet vetëm me miratim zyrtar dhe duhet të shpërndahet te të gjithë organizatorët dhe klubet.
2. Në çdo çështje që nuk trajtohet në këtë rregullore, zbatohen rregullat dhe normat ndërkombëtare të BISFED.

Neni 15  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi Ekzekutiv i FPBOK-së.

Kryetari i FPBOK-së

Murat Murati

---

Prishtinë, 22.05.2025